



VENDIM

Nr. 72, Datë 27.05.2016

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OSHEE SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR SHËRBIMIN E SHPËRNDARJES DHE ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PËRIUDHEN 1 KORRIK-31 DHJETOR 2016

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, VKM nr. 244 date 30.03.2016 “Për miratimin e Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike” si dhe të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes me pakicë për klientët tariforë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 Korrik-31 Dhjetor 2016.

Konstatohet se:

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 Korrik-31 Dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 Korrik-31 Dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI